



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 23

Prishtinë, më: 04.11.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Fadil Demaku, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Ganimete Musliu, Nuredin Ibishi dhe Anton Quni-anëtar të Komisionit

Munguan: Daut Haradinaj –Kryetar i Komisionit, Zafir Berisha, Rexhep Selimi-anëtar

Stafi Mbështetës: Nur Çeku

Mbledhjen e kryesoi: Fadil Demaku, nënkryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 14.09.2015;
3. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit Nr. 04 /L-076 për Policinë
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 14.09.2015;

Procesverbali u miratua me vërejtje nga deputeti Qerim Bajrami, lidhur me diskutimin e tij në pikën të ndryshme por tha konkretisht do tu komunikojnë stafit të komisionit bejnë ndryshimin në procesverbal.

Kryesuesi konstatoi se miratohet procesverbali mbledhjes së komisionit i datës 14.09.2015 me vërejtjen e deputetit Qerim Bajrami

3. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë

Kryesuesi- Komisioni kohë më parë ka cakuar një grup punues për mbikëqyrjen e Ligjit për Policinë, kryesuesi i këtij grupi punues është z.Nuredin Ibishi, grupi punues gjatë kësaj kohe ka pasur shumë aktivitete në drejtim të mbikëqyrjes së zbatueshmërisë së këtij ligji, kisha kërkuar nga z. Ibishi që të informoj Komisionin për të gjitha aktivitetet e grupit punues deri më tani.

Nuredin Ibishi- Mbikëqyrja e Ligji për Policinë e Kosovës ka filluar më herët, tani jemi në përfundim të mbikëqyrjes. Do të bëjë një përshkrim të shkurt kronologjik të aktiviteteve tona për zbatimin e këtij ligji, kemi drejtuar një pyetësor Ministrisë së Punëve të Brendshme nga Komisioni, kemi marr përgjigjet nga Ministria e Punëve të Brendshme, kemi pasur një dëgjim publik, ku kanë qenë të pranishëm përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, përfaqësues nga shoqëria civile, kemi debatuar lidhur me përgjigjet e marra, grupi punues ka vazhduar me vizitat në teren sipas planit të veprimit të Komisionit, ku kemi grumbulluar të dhëna të rëndësishme që do t'i kemi në raportin final të grupit punues. Kemi pasur vizita në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policinë e Kosovës, Inspektoratin Policorë të Kosovës, Akademin e Sigurisë Publike, Agjensionin e Forenzikës, Prokurorinë dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë, Avokatin e Popullit, Drejtorinë e Standardëve Profesionale, Stacionin Policor të Policisë Kufitare në vendkalimin në Merdarë, ne kemi bërë edhe një pyetësor shtesë nga këto vizita, tani na ka mbetur vetëm edhe një vizitë si Komision në Rajonin Policorë të Prizrenit, gjithashtu është diskutuar edhe lidhur me vizitën në Stacionin Policor në Mitrovicë të Veriut. Medoj që me punën e deri tashme ja kemi dal të mbikëqyrim se si policia i realizon të hyrat e veta, si bashkëpunon me gjithë akterët e tjerë edhe në kuadër të sigurisë por edhe në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si të gjitha institucionet që nuk po e zbatojnë detyrimin që nuk e bëjnë raportin vjetor të zbatimit të ligjit që është detyrë e çdo resori ministror. Përgjithësisht si kyesues i grupit punues janë i kënaqur me punën e deri tashme, kemi pasur mirëkuptim me të gjithë. Para se raporti të bëhet me rekomandime kemi edhe një dëgjim publik me shoqërit civile dhe të gjithë akteret e tjere që mendojnë se mund të japin kontributin e vet.

Kryesuesi- Pasi të marrin fjalën edhe kolegët tjerë deputet në fund do të kemi një përfundim të përbashkët për agjendën e mëtutjeshme të grupit punues, sa i përket këtyre dy vizitave që doni t'i realizoni, duke pasur parasysh që policia është një ndër segmentet më të rëndësishme të shtetit, komisioni ynë është duke bërë një punë jashtëzakonisht të rëndësishme në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe të gjitha vështirësive, në radhë të parë ne si deputetë dhe si Komision,

shohim se sa është funksional ligji, të janë më të informuar opinion me segmentet të rëndësishme që trajtohen mbrenda ligjit të policisë.

Ganimete Musliu- Falenderim i veçant shkon për ekspertët si nga ana e Policisë ashtu edhe nga ana e Inspektoratit Policor, të cilët kanë qenë shumë konstruktiv gjatë gjithë punës që kemi bërë ne si grup punues, poashtu një respekt edhe për punën e grupit punues me kryesues z. Nuredin Ibishi, i cili me të vërtetë ka bërë një punë me të vërtetë të jashtëzakonshme, në zhillimin e aktiviteteve tona rreth mbikëqyrjes së këtij ligji, konsideroj që edhe si grup punues do të dalim me një përfundim ku do t'i rekomandoj edhe Kuvendit për nevojat e plotësimit ndryshim të këtij ligji sepse shpeshherë kemi hasur në propozime që janë jepur nga ekspertët e fushës së caktuar, prandaj pasi që gjysma e punës veq se është kryer sa i përket këtij ligji, konsideroj që nuk duhet të vonohemi shumë me caktimin e agjendës tonë për vizitat e mbetura në teren, që brenda afati kohor të caktuar ta përfundojmë si raport dhe të marrim hapat tutje sa i përket këtij ligji.

Qerim Bajrami- Insistoj që sa më shpejt të realizojmë edhe vizitën e planifikuar në Stacionin Regional të Prizrenit sepse kemi disa probleme specifike në këtë regjion, posaçërisht plaqkitje të vazhdueshme. Është mirë të diskutohet për këtë problem që policia të forcohet në mënyrë që të luftohet kjo dukuri.

Ganimete Musliu- Deshta vetëm të propozoj që të futet në agjendë si mundësi e takimit me Shoqatën e Grave Police të Kosovës, konsideroj që ato mund të japin një kontribut të jashtëzakonshëm.

Anton Quni- Desha të bëjë një ndërlidhje me punën e një grupi punues që ka punuar mandatin e kaluar, që ka pasur po të njejtin material dhe më kujtohet së atëherë kemi ardhur me disa konkludime dhe rekomandime, sygjerohet që grupi punues ta ketë parasysh edhe këtë çështje se sa kanë krijuar efekt ata konkludime dhe rekomandime në mandatin e kaluar, që mos të bëhet kjo formë vetëm sa për ta plotësuar formën por që në të vërtetë të krijoj efekt edhe të bëhet si pjesë e kulturës në të ardhmën.

Bojan Mitiq- Përsëritet për nënkryetarin dhe të gjithë të pranishmit. Unë gjithashtu pajtohem me kolegët e mi për atë çka thanë deri me tani ,dhe pajtohem me koleg që sa më shpejtë të organizojmë vizitat në teren, në Prizren dhe në veri të Kosovës. Mendoj që këto vizita e kanë efektin e vet dhe mendoj se njëzë do të afrohen, ata të veriut me ata të jugut. Unë do ta jap kontributin tim aq sa mundem dhe në princip kjo është e gjitha.

Nuredin Ibishi- Është mirë të parashihet vizitë edhe në Drejtorinë për Trafik, për arsyeje se kohëve të fundit tregohet një rritje enorme e aksidenteve të trafikut. Në do të mundohemi të nxjerrim një raport me rekomandime që mos të mbetet vetëm në letër po që me të vërtetë të zbatohet.

Qerim Bajrami- ftoj deputetet e opozitës të jenë të pranishëm nëpër vizitat e grupit punues, posaçërisht në Prizren, pasi që si shqetësim për situatën në Prizren e ka ngritur bashkë me Zafir Berishën

Kryesuesi-Natyrisht që ka shumë çështje të diskutueshme sa i përket edhe segmenteve të cakurara të Policisë apo edhe lidhur me fenomenet e ndryshme që po ndodhin, se a është Policia e Kosovës në nivelin e duhur, kjo është çështje tjetër që mund të diskutohet nga komisioni më vonë, të fokusohemi njëherë në planin e punës që e kemi si Komision në zbatueshmëri të ligjit dhe pastaj në bazë të rezultatit konkret ne si Komision do jemi shumë më kompetent në fokusimin e çështjeve të caktuara, sikur që është për trafikun edhe problematikat të tjera që u ngriten. Z.Nuredin Ibishi, kisha kërkuar që ju si kryesues i grupit punues të caktoni vet agjendën e takimeve për javën e ardhshme, në koordinim me anëtarët e grupit,

Qerim Bajrami- ftoj deputetet e opozitës të jenë të pranishëm nëpër vizitat e grupit punues, posaçërisht në Prizren, pasi që si shqetësim për situatën në Prizren e kemi ngritur bashkë me deputetin Zafir Berishën

Kryesuesi- Konstatoi se komisioni pas përfundimit të debatit për këtë pikë nxorri këtë:

PËRFUNDIM

Komisioni në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit për policinë do të realizojë vizita punë në Drejtorinë Rajonale të Prizrenit, në rajonin e Mitrovicës së Veriut, takim me Shoqatën e Grave Police dhe Njësinë e Trafikut.

5. Të ndryshme

Nuk pati diskutime në kuadër të kësaj pike.

.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetari i Komisionit,

Fadil Demaku